



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS  
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

---

**Raporti i tremujorit të tretë i  
Odës së Mjekëve të Kosovës**



Shtator 2018


Prishtinë

## Përmbajtja:

Funksionalizimi Organizativ i .....	1
1. Antaresimi .....	3
2. Bartja e Kompetencave.....	3
2.1 Mbikqyrja Etiko Profesionale .....	3
2.2 Edukimi i Vazhdueshem Profesional dhe Licencimi .....	4
3. Gjendja financiare 01 Janar 2018 -31 Shtator 2018 .....	6
4. Infrastruktura Juridike .....	6
5. Aktivitete tjera .....	7
5.1 Faksimilet (Vulat).....	7
5.2 Konkurs per punesim .....	7
5.3 Edukimi Specialistik-bartja e kompetences .....	7
5.4 Renovimi objektit per shfrytezim nga OMK.....	8
5.5 Tryeze e rrumbullaket .....	8
5.6 Sondazhe dhe Hulumtime .....	8
5.7 Antaresimi ne Komitetin e Përhershëm për mjekët e Evropës (CPME) .....	9
6. Projekte afatgjata.....	9

## 1. Antarësimi

- Antarësimi në Odën e Mjekëve të Kosovës ka filluar me datën 30 Janar 2018 dhe deri me tani në OMK janë antarësuar 3600 mjek
- Ne Kuvendin e datës 05.mars.2018, me të cilin është ndryshuar Vendimi i Kuvendit i vitit 2017, është përcaktuar kuota e antarësisë në shumë prej 0.8% të pagës neto për të gjithë mjekët e punësuar në sektorin publik dhe atij privat, ndërsa për mjekët shtetas jokosovar që janë të angazhuar në sektorin privat, 250.00€ për vit kalendarik.




- Në këtë periudhë, OMK ka bërë edhe printimin dhe shpërndarjen e Kartelave të anëtarësisë të cilat përveq tjerave do të synohet të bëjnë të mundur edhe regjistrimin dhe evidentimin automatik të vijimit të anëtarëve tonë në ngjarjet e EVP-së, falë paisjeve përcjellëse elektronike.

## 2. Bartja e Kompetencave

### 2.1 Mbikqyrja Etiko Profesionale

- Vendimi i datës 22 shkurt 2018 për bartjen e kompetencave nga Bordi Qendror Etik i MSH-së tek Këshilli Etiko-Profesional i OMK-së, ka shënuar edhe funksionalizimin e këtij organi të OMK-së.
- Duke filluar nga kjo datë Këshilli Etiko Profesional ka pranuar 17 lëndë, ku ka marrë vendime për 8 lëndë, 7 lëndë tjera janë përcjell tek Prokurori i OMK-së dhe dy lëndë kanë qenë me afat të parashkruar.
- Prokurori i Odës ka përcjellur një lëndë tek Gjyqi i Nderit.

- Gjyqi i Nderit ka marre vendim për nje lënd




- **Sfidat apo vështirësitë** të cilat e kanë përcjellë Këshillin Etik të OMK-së që nga fillimi i punës në shkurt 2018 deri më tani kanë qenë të natyrës së shqyrtimit të lëndëve ku për objekt trajtimi ka qenë shkelja profesionale e profesionistëve shëndetësor, dhe si rrjedhojë e kësaj sfide Këshilli Etik ka propozuar që të hartohen dy Rregullore, si në vijim:
  - Rregullore mbi kategorizimin e shkeljeve profesionale për dallim nga ato etike që janë të përcaktuara me Kodin Etik, dhe
  - Rregullore mbi format dhe procedurat e angazhimit të ekspertëve për vlerësim profesional: trajnimi, çertifikimi, format e kompensimit dhe sanksionimit.


## 2.2 Edukimi i Vazhdueshëm Profesional dhe Licencimi

- Me datën 26.04.2018, është bërë bartja formale e kompetencës së Edukimit të Vazhdueshëm Profesional, Licencimit dhe Rilicencimit tek organet kompetente të OMK-së.
- Duke filluar nga kjo datë OMK, ka akredituar 43 aktivitete, dhe ka ofruar përkrahje për 7 aktivitete dhe 4 individë

## Komisioni për EVP



- Ndërsa duke filluar nga data 26 Prill 2018, Komisioni për Licencim dhe Ri-licencim ka lëshuar 478 licenca me kategoritë si në grafikonin me poshtë:



### **3. Gjendja financiare 01 Janar 2018 -31 Shtator 2018**

	TM3	Realizimi: 1 Janar 2018 – 30 Shtator 2018
<b>1.0 Të hyrat:</b>		
1.1 Anëtarësia:		
1.1.1 Anëtarësimi i mjekëve nga sektori publik	52,751.25	115,649.12
1.1.2 Anëtarësimi i mjekëve nga sektori privat	3,430.35	37,532.46
1.1.3 Anëtarësimi i mjekëve qytetar jo Kosovarë	1,500.00	5,000.00
<b>Total të hyra nga anëtarësia</b>	<b>57,681.60</b>	<b>158,181.58</b>
1.2 Licencimi	14,360.00	30,611.00
1.3 Të hyrat e tjera	4,925.54	9,487.54
<b>TOTAL TË HYRAT</b>	<b>76,967.14</b>	<b>198,280.12</b>
<b>2.0 SHPENZIMET</b>	<b>TM3</b>	<b>Shpenzimet: 1 Janar 2018 – 30 Shtator 2018</b>
2.1 Paga dhe kontributet pensionale	12,188.28	35,885.81
2.2 Meditjet	13,363.90	38,643.54
2.3 Material shpenzues	689.48	2,653.65
2.4 Reprezentacioni	234.40	341.00
2.5 Edukimi I Vazhdueshëm Profesional	6,457.50	6,820.30
2.6 Shpenzimet e tjera	1,534.93	2,676.95
2.7 Përkrahje financiare në kuadër të fondit për solidaritet	1,000.00	1,000.00
<b>TOTAL SHPENZIME</b>	<b>35,468.49</b>	<b>88,021.25</b>
<b>Bilanci me 31 Gusht 2018</b>	<b>41,498.65</b>	
<b>BILANCI TOTAL: 1 Janar 2018 – 30 Shtator 2018</b>		<b>110,258.87</b>

#### **Sfidat:**

- Mangësi në procedimin e listave në plotni nga ana e Departamentit të Pagesave në MF;
- Deklarimi jo real i të ardhurave nga mjekët e sektorit privat, pjesa që paguajnë 0.8% e rrogës neto;
- Ikja nga pagesa e një numri të konsiderueshëm të mjekëve të huaj.

### **4. Infrastruktura Juridike**

- Kuvendi i OMK-së ka mbajtur mbledhjen e rregullt me 19 qershor 2018, në të cilën janë miratuar një sërë të akteve normative:
  - Rregullorja për Regjistrimin, Licencimin dhe Rilicencimin e Mjekëve;

- Rregullorja për Edukimin e Vazhdueshëm Profesional;
  - Rregullorja për Procedurat Vendimmarrëse të Organeve të OMK-së;
  - Rregullorja për Përcaktimin e Llojeve të Shkeljeve Etike dhe Procedurat e Mbikëqyrjes Etike;
  - Rregullorja për Menaxhimin e Financave të OMK-së;
  - Rregullorja për Punën e Komisionit për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke; dhe
  - Rregullorja për Fushëveprimin dhe Kompetencat e Komisionit për Çështje Etike.
- OMK, ka ndërmar dhe ka hartuar draftet e para të dy iniciativave ligjore, ku kemi marrë edhe mbështetjen e Ministrit të Shëndetësisë z. Ismajli, Ministrit të Drejtësisë z Tahiri dhe anëtarëve të Komisionit Parlamentar për Shëndetësi dhe Mirëqenje sociale. Këto dy iniciativa janë:
    1. Ligji mbi të drejtat dhe obligimet e mjekut
    2. Udhëzimi Administrativ mbi rregullimin e çështjes së expertizave gjyqësore në lëmin e mjeksisë.

## **5. Aktivitete tjera**

### **5.1 Faksimilet (Vulat)**

- OMK-ja gjatë muajit gusht ka shpallë ftesën publike për ofertë për punimin/prodhimin e autorizuar të faksimileve sipas formës së miratuar dhe përmbajtjes që është përcaktuar me Nenin 21, paragrafin 4 të Rregullores për Regjistrimin, Licencimin dhe Rilicencimin e Mjekëve.
- Me datën 18.09.2018 është nënshkruar kontrata me ofertuesin fitues
- Prodhimi i faksimilave dhe shpërndarja do të fillojn në nëntor fund vitit 2018, duke vazhduar me shpërndarjen në fillim vitit 2019
- Prandaj, të gjithë mjekët që ofrojnë shërbime shëndetësore dhe ushtrojnë veprimtarinë e tyre në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës, nga data 1 janar 2019 do të jenë të obliguar që të pajisen me faksimilet unike të prodhuara nën autoritetin e OMK-së

### **5.2 Konkurs për punësim**

- Me 21 Shtator, OMK-ja ka shpallur konkurs për katër pozita për stafin e shërbimit profesional. Konkursi ka mbet i hapur 15 dite nga dita e shpalljes. Pozita të shpallura janë si në vijim:
  1. Asistent/e Administrativ/e pranë zyrës së Kryetarit (1 vend pune)
  2. Asistent/ e Ligjor/e për Komisione të Përhershme të Odës (1 vend pune)
  3. Asistent/e Administrativ/e për Komisionet e Përhershme të Odës (1 vend pune)
  4. Zyrtar/e Ligjor/e (1 vend pune)

### **5.3 Edukimi Specialistik-bartja e kompetencës**

- Dizajnimi dhe fillimi fazës tranzitore të bartjes së kompetencave të edukimit specialistik (zbërthimi ligjor, financiar dhe teknik) është në proces e sipër

## 5.4 Renovimi objektit për shfrytëzim nga OMK

- Me mbeshtetje të Pojktit KSV/017, projekt ky bashkpunimi mes qeverisë së Luksemburgut dhe të Republikës së Kosovës, Programi përkrahës për shëndetësi do të bëhet renovimi i objektit për shfrytëzimin e Odës së Mjekëve
- Me këtë rast është nënshkruar marrëveshja mes OMK-së dhe Ministrisë së Ddrejtësisë
- Objekti i cili do të renovohet është një pjesë e hapësirës të Institutit të Mjekësisë Ligjore e cila gjendet në objektin e Instituteve në QKUK.
- Tenderi për renovim tani veq është hapur dhe do të jetë i hapur deri me 11.10.2018
- Bartja ne objektin e renovuar pritet të bëhet në muajin Dhjetor

## 5.5 Tryezë e rumbullakët

- Me qëllim të avansimit të rregullimit të brendshëm normativ, OMK-ja në planin e saj të punës për tremujorin e fundit të vitit 2018 ka planifikuar mbajtjen e një Tryeze të Rumbullakët. Data potenciale për mbajtjen e tryezes, 21 dhe 22 Nentor 2018.
- Në këtë tryezë do të diskutohen nevojat modifikimit të akteve normative (përfshirë këtu Statutin e Odës, Kodin Etik dhe aktet të tjera normative) dhe plan veprimi për vitin 2019
- Ndryshime do të propozohen dhe shqyrtohen në mbledhjen e ardhshme të Kuvendit të OMK-së, që planifikohet të mbahet në javën e parë të muajit Janar 2019.
- Në këtë ngjarje, OMK-ja do të ftoj përfaqësuesit e Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Qeverisë së Luksemburgut, respektivisht përfaqësuesit të Lux Development në kuadër të Projektit KSV/017 “Përkrahja në Sektorin e Shëndetësisë”, që në cilësi të partnerëve në realizimin e objektivave të ligjshme, të konsultohen dhe të japin kontributin e tyre në forcimin e mëtutjeshëm organizativ dhe juridik të OMK-së.

## 5.6 Sondazhe dhe Hulumtime

### 5.5.1 Sondazhi - Sigurime Profesionale

- Gjat javës së fundit të muajit Shtator, OMK ka lansuar nje sondazh brenda anëtarësisë, lidhur me Sigurime Profesionale ku muren pjesë 827 mjekë.
- Oda e Mjekëve të Kosovës përmes këtij hulumtimi ka për qëllim që të analizojë indikatorët e brendshëm nga anëtarët e saj (mjekët) në kuptim të zbatimit të një sistemi të tillë të sigurimeve.

- Rezultate të këtij sondazhi janë shfaqur në ueb faqen e OMK-së:

<https://omk-rks.org/omk-implementon-sondazhin-per-sigurime-profesionale/>

### 5.5.2 Hulumtimi - Kujdesi dhe qasja e mjekut ndaj pacientit

- Në bashkëpunim me Organizatën e Studentave Mjekësisë – KOMS, OMK ka filluar implementimin e hulumtimit “Kujdesi dhe qasja e mjekut ndaj pacientit”



- Objektivat kryesore e këtij hulumtimit janë:
  - Matja dhe njohja e nivelit të kënaqshmërisë së pacientëve lidhur me ofrimin e shërbimeve mjekësore
  - Identifikimi i shkaqeve të pakënaqësisë së pacientëve me shërbimet shëndetësore të pranuar
  - Matja e nivelit të njohurive të popullatës lidhur me kompetencat publike dhe rolin e Odës së Mjekëve të Kosovës.
- Publikimi i të gjeturave nga ky hulumtim pritet të bëhet në fund Nëntorit 2018

### **5.5.3 Sondazhi - Perceptioni i mjekut mbi raportimet e mediave mbi mjekët**

- Implementimi i këtij sondazhi planifikohet të bëhet në fund muajit Djator 2018

## **5.7 Antarësimi në Komitetin e Përhershëm për mjekët e Evropës (CPME)**

- Oda e Mjekëve është duke pergatitur kërkesën për antarësim në Komitetin e Përhershëm për mjekë të Evropës (CPME)
- Kuvendi i CPME do të takohet me datën 09-10 Nëntor 2018 në Gjenevë, ku do të shqyrtohet kërkesa e OMK-së

## **6. Projekte afatgjata**

- Ndërtimi i një objekti për të gjitha OPSH – Mbështetur nga MSH, financuar nga Projekti KSV/017 “Përkrahja në Sektorin e Shëndetësisë”
- Krijimi i Sistemit Informativ/Databazë interaktive ku do të përfshihen të gjitha proceset e OMKsë. Kohezgjatja e projektit – 1 vjet (Lux Dev)
- Krijimi i arkivës digitale